KËRKESË
Nr. 6596/6, datë 15.11.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i një Qendre Multifunksionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara", në fshatin Poshnjë, Bashkia Ura Vajgurore.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Beratit për vitin 2016, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 783,335 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

TABELA PARAPRAKE E PRONARËVE, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NJË QENDRE MULTIFUNKSIONALE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA", NË FSHATIN POSHNJË, BASHKIA URA VAJGURORE

Nr.	**Emër Mbiemër**	**Lloji i pasurisë**	**ZK**	**Nr. i pasurisë**	**Sip. totale**	**Sip. e prekur (m^2)**	**Çmimi i objektit**	**Vlera në lekë**	**Shënime sqaruese**
1	Islam Halim Qemalaj	Ndërtesë (banimi)	3032	456/6+1-4	60	60	783335	783335	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale paraprake						**60**			**783335**

Shënim. Vlerat e shpronësimit është llogaritur në bazë të kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e Entit të Banesave për qytetin e Beratit, për vitin 2016.